



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1426 / Prot.

Patos, më 11 / 06 / 2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 10 QERSHOR 2026

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:30

Dëgjuesë publike me temë: “Plani Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve 2026-2030 dhe Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor mbi Planin e mbetjeve”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës së drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik me nr. 1426 prot, datë 29.04.2026 “Për realizimin e konsultimit publik për Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve 2026-2030 dhe Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor”.

Pjesëmarrës: Sekretar i Këshillit Bashkiak, znj. Refaela Xeba, Sekretar i Përgjithshëm znj. Juella Shpata, përfaqësues të bashkisë Patos, banorë, përfaqësues të shoqatave dhe shoqërisë civile, kryetarë të fshatrave etj.

21 pjesëmarrës

Takimin hapet nga sekretar i Këshillit znj. Refaela Xeba- Të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit



Sekretar i Këshillit

znj. Refaela Xeba

Dëgjese publike me temë:

**“Plani Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve
2026-2030 dhe Raporti i Vlerësimit
Strategjik Mjedisor mbi Planin e mbetjeve”
Qershor 2026**

Bashkiak “Për konsultimin publik”, jemi këtu sot për të prezantuar para jush dokumentin përfundimtar lidhur mbi Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve 2026-2030 dhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor mbi Planin e mbetjeve. Ftoj ekzekutivin të prezantoj materialin dhe sipas rregullave mund të drejtoni pyetjet tuaja.

Drejtore i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj– Përshëndetje të gjithëve! Sot po prezantojmë në këtë dëgjese Planin e Menaxhimit të Mbetjeve. Ky plan risillet sikurse dhe



Drejtore

Znj. Mimoza Shtëmbari

Dëgjese publike me temë:

**“Plani Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve
2026-2030 dhe Raporti i Vlerësimit
Strategjik Mjedisor mbi Planin e mbetjeve”
Qershor 2026**

herën e kaluar për dëgjese. Ka disa ndryshime nga dispozitat ligjore lidhur me këtë fushë. Këto ndryshime do të vihen në funksion. Po e nisim me infrastrukturën që ne kemi sot di bashki Patos për menaxhimin e mbetjeve. Ky lloj shërbimi si fillim dua të theksoj që ofrohet nga vet bashkia Patos nëpërmjet ndërmarrjeve të saj të krijuara për menaxhimin jo vetëm të mbetjeve, por dhe veprimtarive të tjera që ka bashkia. Infrastrukura e sotme përbëhet nga kontenier të grumbulimit të mbetjeve. Dua të theksoj faktin se vitin e kaluar nga ana e bashkisë Patos në lagjen Grizë dhe një pjesë të lagjes 29 Marsi janë shpërndarë kontenier të personalizuar. Kjo u bë për të eksperimentuar dhe testuar pjesën e ndarjes në burim të

mbetjeve. Gjithashtu u bë dhe për të rritur përgjegjshmërinë dhe kulturën e qytetarëve lidhur me pjesën e menaxhimit të mbetjeve. Urojmë që kjo mënyrë të ketë qënë e suksesshme. Është menduar që do të kemi lagje të tjera të tilla për ndarjen në burim të mbetjeve që klasifikohen në tre grupe qelqore, kartoni dhe mbetje ushqimore. Ndarja që në burim ul dhe kostot e trajtimit të tyre. Ndryshimet ligjore kanë parashikuar krijimin e bazave të grumbullimit të këtyre mbetjeve me bazë rajonale. Grumbullimi i mbetjeve do të jetë me bazë rajonale dhe më pas trajtimi i tyre do të bëhet nga industrit që janë funksionale që ne i quajmë inceneratorë. Jemi ende në pritje të udhëzimit për të detajuar se si do të funksionoj kjo fazë. Bashkia Patos ka tre njësi administrative. Kemi zona bujqësore që kanë mbetje bujqësore që janë të padëmshme, por kanë nevojë për trajtim. Janë mbetje që krijohen nga qytetarët për nevoja konsumi dhe ambalazhet e konsumit janë të ndara në substanca të ndryshme. Kemi dhe një zonë në Zharrëz dhe Rrerës që preken nga industria naftënxjerrëse dhe funksioni i kësaj veprimtarie kryhet nga kompani të ndryshme. Në Zharrëz që përfshihet vendburimi naftës Patos Marinëz operon kompania Bankers. Në Visokë, Rrerës dhe Kuqar operon kompania Terra Oil. Këto kompani hera herës krijojnë problematika që ne ndeshemi dhe i fusim në rrugën e zgjidhjes duke bashkëpunuar jo vetëm me kompaninë por dhe me organe të tjera që mbikëqyrin pjesën e mjedisit brenda qarkut që ne bëjmë pjesë. Çdo plan ka kostot e veta për zbatim. Kostot për shkak të infrastrukturës që kërkon investim dhe shtimin e kontenerëve do të jenë në rritje. Objektivat tonë në këtë plan synojnë uljen e kostos duke bërë ndarjen në burim sepse edhe pjesa e tarifave është në nivelin 60% që nuk mblulon kostot e shërbimeve që jepen. Qasja do të jetë një qasje drejt standardeve të bashkimit europian. Në thelb pjesa e menaxhimit të mbetjeve aktualja dhe ajo që ne kemi si objektiv janë këto që përmenda pak më sipër. Ky ishte plani i mbetjeve për periudhën 2006-2030. Do të doja të përmendja dhe pjesën e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për këtë plan që është një dokument i cili mbështetet plotësisht mbi planin e mbetjeve si dokument shoqërues që ka në thelb sigurinë dhe mbajtjen pastër të ambjentit.

Kimiste në Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Fier, znj. Etleva Kaçani-



**Kimiste në NJVKSH Fier
znj. Etleva Kaçani**

Dëgjësë publike me temë:

**“Plani Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve
2026-2030 dhe Raporti i Vlerësimit Strategjik
Mjedisor mbi Planin e mbetjeve”**

Qershor 2026

Përshëndetje! Ju në Planin tuaj thatë që do të përpunoni vetëm tre letrën, qelqin dhe mbejtet e tjera, por sot po bëhet një luftë shumë e madhe ndaj plastikës, i cili është faktori kryesor i ndotjes së ambjentit. Mos duhet vlerësuar edhe kjo duke krijuar një kontenier edhe për plastikën? Dhe dua të di plani juaj si do funksionoj? Ju do të vendosni kontenierët dhe ju do detyroni ndrajen që në shtëpi apo si do funksionoj? Pra ndarja në burim do të bëhet që në banesë?

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj- Pjesa e plastikës ishte në moment që kaloi nga ana ime dhe dua të theksoj që është pjesë e planit dhe ajo do ketë pjesën e ndarjes dhe kontenierit. Kontenierët do të jenë jashtë ambjenteve familjare dhe me krijimin e kushteve për trajtimin e mbetjeve nëpërmjet kompanive. Kjo infrastrukturë u jepet nga bashkitë kompanive dhe kompanitë investojnë në infrastrukturë. Ose do ketë një marrëdhënie që do të lehtësohet taksapaguesi nëpërmjet një marrëdhënie që do krijoj bashkia me vet operatorin.



**Drejtor i Zhvillimit Ekonomik
z. Çajup Refitaj
Dëgjesë publike me temë:
“Plani Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve
2026-2030 dhe Raporti i Vlerësimit
Strategjik Mjedisor mbi Planin e mbetjeve”
Qershor 2026**

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Eduart Faslliaj- Përshëndetje! A ka bashki që kanë



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Eduart Faslliaj
Dëgjesë publike me temë:
“Plani Lokal të Menaxhimit të
Mbetjeve 2026-2030 dhe Raporti i
Vlerësimit Strategjik Mjedisor mbi
Planin e mbetjeve”
Qershor 2026**

implementuar këtë plan më herët? Nëse ka a ka funksionuar ky plan? Keni marrë ju në konsideratë që mosha mesatare e popullsisë banues në bashkinë tonë është rritur dhe pjesa më e madhe janë mosha 50 vjeç e sipër dhe në mentalitetin e tyre nuk e kanë në kulturë ndarjen

në burim. Kam frikë se do ngelemi te pjesa e dëshirës së mire dhe kostove të shpenzuara dhe një produkti jop të mirë.

Drejtor i Zhvillimi Ekonomik, z. Çajup Refitaj – Për të qënë i sigurtë nuk di të them për bashkitë e tjera se si kanë operuar, por them që nuk jemi në të parët. Detyrimisht ky plan del mbi këto konkluzione dhe për këtë lloj infrastrukture sepse në çdo hap që hedhim elementi



**Drejtor i Zhvillimi Ekonomik
z. Çajup Refitaj**

**Dëgjësë publike me temë:
“Plani Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve
2026-2030 dhe Raporti i Vlerësimit
Strategjik Mjedisor mbi Planin e mbetjeve”
Qershor 2026**

kosto është ai që na shoqëron dhe ndarja që ne burim na ndihmon të ulim këto kosto për trajtimin e mbetjeve. Ne do të pilotojmë këtë projekt në lagje të ndryshme për të parë se si do të funksionoj. Më pas do të shtrihet në të gjithë territorin e bashkisë. Për sa i përket pilotimit ai do filloj dhe në shkollë në mënyrë që ky plan të jetë i konstituar nga pikëpamja kulturore.

Përfaqësues i shoqatës ambientaliste, z. Qani Rredhi – Përsëritet! Kam një pyetje. A ka filluar punë inceneratori? A djeg mbetje? Ne si OJF kemi marrë pjesë në shumë dëgjesa publike dhe dëgjojmë të njëjtat gjëra. Para 3 vjetësh kemi paraqitur një projekt për ndarjen e mbetjeve në bashkinë Patos, të cilin nuk e fituam. Ky plan që prezantuat lë për të dëshiruar. Njësia Zharrëz është pa kontenier dhe ka ndotje hidrokarbure. Në Zharrëz kemi pasur edhe humbje jete nga ndotja e hidrokarbureve. Çfarë keni parashikuar ju lidhur me këto mbetje hidrokarbure? Ju keni bërë vetëm rrethim të gropave. Shikoj që postohen pastrime kanalesh



**Përfaqësues i shoqatës ambientaliste
z. Qani Rredhi
Dëgjësë publike me temë:
“Plani Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve
2026-2030 dhe Raporti i Vlerësimit
Strategjik Mjedisor mbi Planin e
mbetjeve”
Qershor 2026**

në faqen e bashkisë, por unë do ju tregoj një video që uji vërshon nga mali dhe dëmton shtëpinë e mbyt serën. Shkaqet e ketyre dëmtimeve janë mbetjet e kompanisë Alb Star që kërkon dhe të rinovoj dhe lejen mjedisore. Atje është e tejmbushur me inerte dhe kërkojmë që të pastrohet. Kompania supozon që ka bërë dhe dëgjese publike, por asnjë nga palët nuk është njoftuar, e kanë bërë fiktive dëgjësën.

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj- Lidhur me pjesën e projektit që preke besoj që keni marrë një përgjigje se pse nuk e keni fituar. Në Zharrëz ne e mbulojmë të



**Drejtor i Zhvillimit Ekonomik
z. Çajup Refitaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve
2026-2030 dhe Raporti i Vlerësimit
Strategjik Mjedisor mbi Planin e mbetjeve”
Qershor 2026**

gjithën me pastrim derë më derë. Për sa i përket indistrit që ju preket lidhur me industrin naftënxjerrëse, ky plan konsiston në mbetje që nuk kanë % hidrokarbure. Për çdo problematik që qytetarët paraqesin pranë nesh, ne bëjmë verifikimet tona dhe i paraqesim këto probleme pranë organeve kompetente sic janë Agjencia Rajonale e Mjedisit për marrje masash. Gjithashtu i drejtohem i vet kompanisë që ka shkaktuar ndotjen. Por ne nuk kemi kompetencë ligjore që të marrim masa ndaj ketyre operatorëve. Lidhur me pjesën e lejeve mjedisore ne si pushtet vendor jemi në kuadrin që thirremi si palë në këto dëgjese dhe përfaqësojmë institucionin dhe qytetarët. Te kompania Asab për lejen mjedisore ne si sektor nuk kemi marr pjesë në këtë dëgjese dhe nuk e di si është zhvilluar.

Sekretar i Këshillit Bashkiak, znj. Refaela Xeba - Ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe



**Sekretar i Këshillit Bashkiak
znj. Refaela Xeba**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve 2026-
2030 dhe Raporti i Vlerësimit Strategjik
Mjedisor mbi Planin e mbetjeve”
Qershor 2026**

për komentet dhe sugjerimet tuaja. Nëse nuk keni diçka tjetër për të shtuar e deklarojmë të mbyllur këtë dëgjese.

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj



Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba

